
Karantina si një karrem për klikim

Hapësira e mediave online kohëve të fundit po zhvillohet me një ritëm shumë dinamik. Ka vërtetë një numër të madh të uebfaqeve dhe sajteve që përpiqen të informojnë. Sidoqoftë, këtu theksi bie te fjala "përpiqen ", sepse këto të ashtuquajtura portale informojnë vetëm duke vjedhur lajme dhe duke praktikuar gazetarinë e mirënjohur “copy-paste”. Informacionet shpesh kopjohen nga faqet tjera, botimet në internet nga mediat e shtypura ose elektronike, dhe shpesh lajmet transmetohen nga gazetarë qytetarë, duke përdorur fotot ose videot e tyre të marra me smartphone. Platforma të tilla në internet në të shumtën e rasteve kanë shikueshmëri të madhe për shkak të ekskluzivitetit të informacionit të shpërndarë, regjistrimeve tërheqëse multimediale dhe titujve interesantë që dinë të tërheqin vëmendjen e një audience të caktuar. Nëse tani e lidhim këtë "trend" me temën më aktuale sot, virusin KOVID - 19 ose virusin korona, situata mund të ndikojë në mënyrë drastike në shëndetin mendor të njerëzve.

Këtyre ditëve hasa në një informacion i cili mund të vendoset pikërisht tek ato tekste të cilat në përmbajtjen e tyre e kanë pjesën “shokante”. Titulli i lajmit është: Karantinimi e bën të veten – Spajdermeni vrapon nëpër Shkup.



Karantinimi e bën të veten – Spajdermeni vrapon nëpër Shkup

Në muajin e fundit shteti jonë ballafaqohet me problem real, ndërsa në këto momente krizash “qytetarët e thjeshtë”, të cilët për çdo ditë informohen për ndodhitë, në fakt

përfaqësojnë pjesën më të ndjeshme të audiencës. Prandaj gjithmonë, e veçanarisht në situata të këtilla, gazetarët e vërtetë duhet që t'i respektojnë e jo t'i keqpërdorin normat dhe principet elementare të etikës gazetareske. Megjithatë, nga informacioni i publikur në uebportalin bulevar.mk mund të vërehet se në kohën e përhapjes së pandemisë përhapen edhe lajmet për klikime.


Малце касниме но мора да се сподели оваа позитивна и луда вест. Минатата година се пријави на маратонот но не учествуваше не знаеме дали се работи за истиот човек сепак носи маска, но скопскиот „Спајдермен" не му е првпат да не забавува.

Burimi: bulevar.mk


Që nga prezentimi fillestar i tekstit mund të konstatojmë se mjafton që të përdoret vetëm ndonjë fjalë që tërheq vëmendjen, si për shembull: "korona", "karantina", "KOVID – 19", që të nxisë interesim dhe lexueshmëri. Kështu që, duke lexuar titullin **"Karantinimi e bën të veten – Spajdermeni vrapon nëpër Shkup"** njëkohësisht e parashtrojmë edhe pyetjen: Në çfarë mënyre dhe sa luan me ndjenjat e audiencës ky titull? A e ka sjellur në të vërtetë karantinimi dhe izolimi këtë njeri – Spajdermenin deri te çrregullimi psiqik? Dhe çka nëse ky informacion që sipas gazetarit ka për qëllim që të zbavisë, dhe siç edhe është theksuar në atë tekst të jetë "lajm pozitiv e i çmendur", në fakt e ka efektin krejtësisht të kundërt? Është ironike ajo që informacioni i shpërndarë nëpërmjet kësaj ueb faqe fare edhe nuk përbën lajm. E njejta pjesërisht mund të nxisë edhe panikë edhe stres tek një pjesë e lexuesve, sepse nga Organizata Botërore e Shëndetsisë edhe zyrtarisht është vërtetuar se karantinimi dhe vetëizolimi mund të kenë ndikime negative. Të moshuarit, veçanërisht ata që janë në izolim dhe ata me rënie kognitive apo demenencë mund të bëhen të shqetësuar, nervozë, të tërhequr dhe më të ekspozuar ndaj stresit gjatë kohës së karantinimit.

Nëse e analizojmë në detaje këtë lajm dhe nëse thirremi në pesë pyetjet kryesore që secili njeri i shkolluar i mediumeve duhet t'ia parashtrojë vetes, e para mund të konstatojmë se autori i kësaj porosie është i panjohur. E njejta është dërguar për të zbavitur, megjithatë është diskutabile a e ka arriturr dhe sa e ka arritur qëllimin e dëshiruar, apo përkundrazi ka shkaktuar krejtësisht efektin e kundërt. Në përputhje me këtë, njerëz të ndryshëm mund në mënyra të ndryshme ta interpretojnë përmbajtjen që e ofron ky produkt mediatik. Njëkohesisht, në vetë tekstin janë shfrytëzuar elemente të manipulimit dhe senzacionalitetit. Autori aspak nuk i përmbahet faktit, por thirret në dy fotografi të cilat i ndërlidh, e të cilat realisht nuk kanë asnjë pikë të përbashkët me karantinimin në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga epidemia. E parë në tërësi mungojnë shumë elemente gazetareske, e rrjedhimisht kjo porosi e degradon kualitetin e informimit të vërtetë.

Njëkohësisht, më duhet të konstatoj që “lajmin gazetaresk” tani më të analizuar, me pak dallim në titull dhe tekst e kam hasur të publikuar edhe në dy ueb portale, e ato janë: infomax.mk dhe zazabava.com, ndërsa e njejta është marrë nga ueb portali crnobelo.mk.







Për fund e parashtrojmë pyetjen sa mund t’u besohet ueb faqeve të përmndura dhe sa të njejtat munden dhe duhen të lirohen nga përgjegjësia për shfrytëzimin e situatës së palakmueshme momentale të shkaktuar nga korona virusi.

Sido që të jetë, një gjë është e sigurtë, pandemia vertetë ndikon në shëndetin psiqik të njerëzve, prandaj ndiqni rekomandimet nga burimet relevante të informimit, si qendrat nacionale të shëndetësisë apo nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ta keni parasysh se jo çdo informacion që lidhet me KOVID – 19 është i vërteteë.

Autore: Ramize Ramadani, 15 vjeçare